

SHERBIMET QE MBULON SEKTORI I PLANIFIKIMIT TË TRANSPORTIT PUBLIK DHE I LICENCAVE

Shërbimi i transportit publik të udhëtareve brenda territorit administrativ të Bashkisë Durrës, kryhet nga operatorët e transportit të cilët janë të pajisur me Licencë nga Bashkia Durrës, konform legjislacionit të transportit rrugor, Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 5627, datë 18.11.2016 “Për percaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për leshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtareve brenda vendit”, i ndryshuar, si dhe vendimeve përkatëse të Këshillit Bashkiak.

Sektori i Planifikimit të Transportit Publik dhe i Licencave pranë Drejtorisë së Projekteve, Infrastrukturës Publike dhe Transportit Publik mbulon këto shërbime:

- Licencë për kryerjen e shërbimeve të rregullta qytetës të transportit të udhëtarëve brenda vendit
- Certifikatë për kryerjen e shërbimeve të rregullta qytetës të transportit të udhëtarëve brenda vendit
- Licencë për kryerjen e shërbimeve të rregullta rrethqytetës të transportit të udhëtarëve brenda vendit
- Certifikatë për kryerjen e shërbimeve të rregullta rrethqytetës të transportit të udhëtarëve brenda vendit.
- Licencë për kryerjen e shërbimeve të rregullta të specializuara të transportit të udhëtarëve brenda vendit
- Certifikatë për kryerjen e shërbimeve të rregullta të specializuara të transportit të udhëtarëve brenda vendit
- Licencë për transport udhëtarësh me taksë.
- Certifikatë për kryerjen e operacioneve të transportit të udhëtarëve për llogari të vet brenda vendit
- Licencë transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit
- Certifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit
- Certifikatë transport mallrash brenda vendit për llogari të vet.
- Leje për zënie hapësire publike.
- Licencë për agjenci transporti udhëtarësh dhe taksë brenda vendit.
- Licencë për funksionimin si stacion shetje të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës dhe vajrave lubrifikante
- Licencë për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse që ushtrojnë veprimtarinë e tyre për përdorim nga konsumatori fundor.
- Leje për subjekte që kërkojnë parkim të rezervuar pranë institucioneve të tyre publike ose private në vende të miratuara për lejim parkimi.
- Leje për vendosje table për qëllime reklamimi në hapësirë publike, për veprimtarinë e subjektit.
- Autorizim për qarkullimin në qytet kundër sinjalit rrugor “Ndalim Qarkullimi”
- Libra Udhëtimi shërbimet turistike/te rastit të udhëtareve brenda vendit.